

AKT-THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "SNEP DISTRIBUTION" shpk

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATIA, SELIA

Neni 1

Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit

1. Sot, më 18.09.2024 ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "SNEP DISTRIBUTION" shpk.

2. Themeluesit e shoqërisë janë

- Z. Silver Nikolla, shtetas shqiptar, lindur ne Krujë, më 23.02.1990, me pasaportë nr. BB6718970 dhe me nr. personal J00223071D, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar;
- Z. Ardiq Duka, shtetas shqiptar, lindur ne Tiranë, më 04.12.1970, me letërnjoftim nr. 032863684 dhe me nr. personal H01204023E, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Objekti

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e meposhtem:

- Import – Export i pijeve të ndryshme si alkolike, jo alkolike etj.;
- Shitje me pakicë dhe shumicë i pijeve të ndryshme si alkolike, jo alkolike etj.;
- Transport dhe shperndarje të mallrave të ndryshëm për vete dhe për llogari të të tretëve.

Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë është me afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia

Shoqëria e ka selinë në:

- Rruga Picar, Magazina Art Gres, Fshati Picar, Bashkia Vorë.

Shoqëria mund të ndryshojë lirisht vendndodhjen e zyrës qendrore të saj, si dhe të çelë degë apo zyra përfaqësimi kudo në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe/ose jashtë saj.



Neni 5

Kapitali themeltar

1. Kapitali themeltar fillestari shoqërisë është 10,000 (dhjetëmijë) Lekë dhe është i ndarë në 2 (dy) kuota. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

Nr.	Emri	Nr.i kuotave	Pjesëmarrja përqindje (%)	Vlera totale e kontributit (Lek)
1.	Silver Nikolla	1	50%	5.000
2.	Ardian Duka	1	50%	5.000

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar
3. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
 - kontributeve në kapitalin e shoqërisë
 - shitblerjes
 - trashegimisë

- dhurimit
 - çdo mënyrë tjetër të parashikuar në ligj
2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.
 3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve dhe onë në palë të treta për sa kohë nuk parashikohet ndryshe në këtë statut.

Neni 8

Organi Vendimmarrës

1. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te përcaktuara ne ligj.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
 - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - d) emërimin e shkarkimin I likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar,
 - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
 - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave;
 - g) financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - h) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - i) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit; pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
 - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një person i tretë.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veproj si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblesë se Përgjithshme

- Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përparrat datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

- Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund. të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 35 për qind të kuotave..
- Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoruminit të përmendor me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zotëruesh te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si:
 - përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- c) përcaktimin e shpërblimeve;
- d) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- e) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- f) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- g) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.

Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet pranë QKB për te pasqyruar ndryshimet ne skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

Neni 13

Administrimi

1. Administratori i shoqërisë emërohet z. Silver Nikolla me numer id. J00223071D, i datëlindjes 23.02.1990, lindur në Krujë dhe banues në Tirane, me afat emërimi 5 vjeçar, duke filluar nga data e themelimit të shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
3. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të 2 emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.
4. Cdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

Neni 14

Kompetencat e Administratorëve



1. Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrëthanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- g) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

2. Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim)
- b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojoë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara)
- c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë shoqërinë. se një administrator , ata e administrojnë bashkërisht

4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.



Neni 16

Ekspertet

1. Eksperti ka për detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
2. Ne përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar qe t'jua paraqesë e dorëzojë ne kohë ortakeve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore qe ka.

Neni 17

Prishja dhe likuidimi

1. Shpërndarje ose prishja e shoqërisë mund të behet ne çdo kohe:
 - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj;
 - b) me vendim të Asamblesë se Ortakeve;
 - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
 - d) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me ligjin;
 - e) me vendim të gjykatës.


Ne ketë rast Ortakët marrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguesve, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 18

Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi, ndarja



Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

Neni 19

Baza Ligjore

1. Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne përputhje te plete me ketë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet ne këtë statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 20

Mosmarrëveshjet

Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posacme të njohura nga ligji. Gjykata kompetente për zgjidjen e mosmarrëveshjeve gjyqësore do te jetë Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë

ORTAKET THEMELUES TË SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

"SNEP DISTRIBUTION" shpk

Silver NIKOLLA

A blue ink signature of the name "Silver Nikolla".

Ardian DUKA

A blue ink signature of the name "Ardian Duka".